



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:270674

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06313726

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0577-A0001

Paditës/Ankues

I J me përfaqësues sipas autorizimit avokatin B I, Prishtinë

Kundër:

E paditura

N.SH. “Famipa” (në likuidim), Prizren, me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë”

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1660, të datës 12 shtator 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 tetor 2024, me shumicë votash lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditësit aprovohet si e bazuar.
2. Ndryshohet, Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1660, i datës 12 shtator 2023 dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ024-0119 të datës 26 gusht 2013.
3. Obligohet e paditura që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës t’i paguaj paditësit shumën prej 3,000.00 euro, në emër të interesit ligjor prej 10% shumën prej 300.00 euro, si dhe në emër të shpenzimeve të përfaqësimit shumën prej 208.00 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Paditësi së bashku me një grup punëtorësh kishte parashtruar një padi grupore, mirëpo me urdhrin e gjykatës me nr. C-IV-13-2002 i datës 26 gusht 2014 ishte bërë ndarja e padive.

Me vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ024-0119 të datës 26 gusht 2013, kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës në shumën prej 3,000.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme pasi që ishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë punëtor aktiv i N.SH-së në kohën e privatizimit të N.SH-së.

Me datë 10 shtator 2015, paditësi kishte paraqitur një parashtrësë për rregullimin dhe plotësimin e padisë. Në këtë parashtrësë kishte theksuar se paditësi ka vetëm një të vërtetë të cilën AKP e kishte konstatuar me tekst të shkruar me dokumentin e saj zyrtar të titulluar “Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës” të vulosur nga AKP-ja dhe nënshkruar nga Drejtori i Departamentit të Likuidimit. Praktika gjyqësore e DHPGJS-së në rastin e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në N.SH “Famipa”, është e qartë. Bindëse dhe konsistente. Aktgjykimet e kësaj gjykate kanë anuluar vendimet e AL-së dhe kanë miratuar kërkesat e punëtorëve për kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës. Gjithashtu, Kolegji i Apelit në rastin e S B AC-I-14-0323 të datës 12 mars 2005, kishte vërtetuar se letërpezullimi i lëshuar nga AKM/AKP është njohje e detyrimeve ndaj kreditorëve. Andaj paditësi gjykatës i kishte propozuar që të miratohet në tërësi padia e tij si e bazuar, ashtu që të obligohet AKP që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës t’i paguaj paditësit shumën e borxhit prej 3,000.00 euro, interesin ligjor prej 10% dhe kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit. Ankesës i kishte bashkëngjitur autorizimin për përfaqësim, një Aktvendim i N.SH “Famipa” me nr. 2/466 si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ024-0119 të datës 26 gusht 2013.

Me datë 14 korrik 2023, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në ankesë në të cilën kishte theksuar se listat e pagave për 6 muajt e fundit para datës së nënshkrimit të kontratës së privatizimit e paraqitur nga menaxhmenti i N.SH-së nuk pasqyrojnë ndonjë pagesë të kryer ndaj parashtruesit të kërkesës. Ky Autoritet i Likuidimit vërejt se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë punëtor aktiv i N.SH kur u privatizua N.SH-ja. Parashtruesi i kërkesës nuk është pushuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga Agjencia. Andaj e paditura duke pasur parasysh këto që u thanë i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet

vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ024-0119 të datës 26 gusht 2013 si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 12 shtator 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1660 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe kishte vërtetuar vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PRZ024-0119 të datës 26 gusht 2013. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi gjykata kishte vlerësuar se pas shqyrtimit të provave të lëndës, pretendimeve dhe parashtrimeve të palëve në procedura gjykata kishte ardhur në përfundim se parashtruesi i padisë nuk ka qenë punëtor aktiv në ndërmarrje në momentin e likuidimit të ndërmarrjes. Sipas bindjes së gjykatës pala paditëse në provat e prezantuara nuk ka mundur që të argumentoj faktet vendimtare të këtij rasti, nuk ka prezantuar kontratë të punës lidhur me ndërmarrjen, listë të pagesës së bërë në emër të pagave apo librezën e punës, të cilat do të dëshmonin se ka pasur të themeluar marrëdhënien e punës në ndërmarrje dhe se i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të procesit të likuidimit të ndërmarrjes.

Me datë 11 tetor 2023, paditësi (ankuesi) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-15-1660 të datës 12 shtator 2023, për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të miratohet në tërësi e bazuar ankesa e ankuesit dhe anulohet Aktgjykimi i ankimuar ashtu që të detyrohet AL që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës t'i paguaj ankuesit shumën e borxhit kryesor prej 3,000.00 euro në emër të 07 pagave për përvojën e tij të punës prej 30 vite ashtu siç është kërkuar me kërkesë, me interes ligjor prej 10% si dhe kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në shumën prej 208.00 euro. Në ankesë ishte theksuar se ankuesi i është përmbajtur njoftimit të lëshuar nga ana e të paditurës dhe ka parashtruar kërkesën e tij ligjore me kompensimin e ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës. Ankuesi ka punuar më shumë se 30 vite përvojë pune dhe sipas ligjit atij i takojnë shtatë paga. Edhe sikur të kishte bazë juridike fakti i mos pagesës së pagave përsëri gjykata e as e paditura në vendimin e saj nuk do të mund të thirreshin në të sepse në cilësinë e punëdhënësit ajo ishte përgjegjëse për pagesën e pagave të paditësit apo për përfundim të kontratës në një mënyrë tjetër të ligjshme e jo asesi e paditura të përfitoj nga shkeljet e detyrimeve të Ligjit të punës dhe atyre të kontratës së punës. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë i kishte propozuar Kolegjit të Apelit si më lartë.

Ankesës i kishte bashkëngjitur: kopjen e librezës së punës së paditësit, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 16 shtator 2011, vendimin e ankimuar të AL-së me nr. PRZ024-0119 të datës 26 gusht 2013, ankesën kolektive të ish punëtorëve dhe listën e punëtorëve të dorëzuar të padive për kompensimin e ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës

Me datë 20 maj 2024, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit në të cilën i kishte propozuar Kolegjit të Apelit që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1660, i datës 12 shtator si dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ024-0119 i datës 26 gusht 2013, duhet të ndryshohen.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 3,000.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme me arsyetimin se nga dokumentacioni i nxjerrë nga arkiva e ndërmarrjes vërtetohet fakti se parashtruesi i kërkesës nuk figuron si një punëtor i N.SH-së në kohën e privatizimit të N.SH-së.

Paditësi në shkallë të parë me rastin e paraqitjes së ankesës së tij kishte bashkëngjitur këto prova: një Aktvendim i N.SH “Famipa” me nr. 2/466 si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ024-0119 të datës 26 gusht 2013..

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin e kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar për arsyen e njëjtë si Autoriteti i Likuidimit, se paditësi nuk kishte dorëzuar asnjë provë në mbështetje të ankesës së tij ashtu që të vërtetonte pretendimet e tij dhe faktin që ka qenë punëtor i N.SH-së në momentin e privatizimit të saj.

Paditësi në ankesën e tij të paraqitur pranë Kolegjit të Apelit kishte vazhduar të kërkoj kompensimin e pretenduar dhe kishte dorëzuar këto prova: kopjen e librezës së punës si dhe njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 16 shtator 2011.

Në këtë rast edhe pse shkalla e parë e DHPGJS-së kishte vendosur drejtë në mungesë të provave. Sipas nenit 70 të Ligjit për DHPGJS, Kolegji i Apelit vendosi t'i pranoj këto prova në interes të drejtësisë.

Kjo për faktin se nga kopja e librezës së punës së paditësit shihet që i njëjti ka ofruar shërbime për N.SH deri në ditën e privatizimit të saj dhe atë me datë 16 shtator 2011, ditë kjo kur edhe i ishte mbyllur librezja e punës.

Provë relevante në këtë rast ishte edhe Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, shihet që paditësit i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, pra me datë 16 shtator 2011. Ky njoftim në përmbajtjen e tij thekson se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*.

Prandaj, paditësi duke vepruar konform njoftimit që i është bërë me datë 16 shtator 2011, ashtu siç theksohet edhe në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit për dorëzimin e kërkesave kishte paraqitur kërkesën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, ashtu siç ishte njoftuar nga AKM-ja.

E paditura në rastin konkret asnjëherë nuk e kishte kontestuar lartësinë e kërkesës për kompensim nga ana e paditësit. Andaj faktet e pakontestuara konsiderohen si të vërtetuara.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit i njeh paditësit të drejtën në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 3,000.00 euro.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi përveç borxhit kryesor kishte kërkuar edhe interesin ligjor. Bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së, paditësit i njihet edhe e drejta në interesin ligjor prej 10% ose në shumën 300.00 euro e cila do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Pasi që pala e paditur është palë e pasuksesshme në këtë lëndë, bazuar në nenin 62.2 të LDHP-së, paditësit i njihet edhe e drejta në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore lidhur me përfaqësimin nga ana e avokatit në shumë prej 208.00 euro, që po ashtu do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 17 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues _____